

VENDIM
Nr. 718, datë 1.12.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
110/20 kV TEC KOMBINAT, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV TEC Kombinat, Tiranë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 4 231 (katër mijë e dyqind e tridhjetë e një mijë) m², "arë", vlerësuar në shumën 28 466 674 (njëzet e tetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.
4. Fondi prej 28 466 674 (njëzet e tetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh, si dhe vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit të përballohen nga OSHEE sh.a., si subjekti që garanton shpenzimet për realizimin e këtij procesi.
5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit dhjetor 2017.
6. Çdo pronar, për t'u likuiduar për efekt shpronësimi, të dorëzojë pranë OSHEE sh.a., Tiranë, dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.
Për pasuritë, për të cilat ZVRPP-ja konfirmon se mbi këtë pasuri është vendosur "Kufizim", pronarët të likuidohen pas heqjes së kufizimit dhe dorëzimit të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të lëshohet nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.
7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet mbi këtë pasuri, deri në përfundim të procesit të kalimit të pronësisë së pasurive të shpronësuara në favor të OSHEE sh.a.
8. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE sh.a., Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



**LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN
NGA NDËRTIMI PËR INTERES PUBLIK TË OBJEKTIT "NDËRTIMI I N/STACIONIT TEC KOMBINAT 110/20 kV
TIRANË"**

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sip që shpronësohen	Vlera në lekë	Shënime mbi dok.	Adresa
1.	Petrit Sadik Shurdhi	3866	302/11	Arë	4231 m ²	28,466,674.00	Konfirmim nga ZVRPP-ja	Yzberisht, Kashar, Tiranë

